



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 26 janar 2015
Nr. ref.: AGJ761/15

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KI72/14

Parashtrues

Besa Qirezi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 712/2013,
të 21 tetorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Besa Qirezi me vendbanim në Vushtrri.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, CA. nr. 712/2013, i 21 tetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 16 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit (CA. nr. 712/2013 i 21 tetorit 2013), me të cilin ishte anuluar Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë (E. nr. 2668/2012, i 11 shkurtit 2013) i nxjerrë në procedurën përmbartimore lidhur me kompensimin e pagave të papaguara nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (në tekstin e mëtejme: MKK) në bazë të Vendimit (A02 (114) 2008, të 25 majit 2009) të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMK-ja).
4. Lidhur me këtë, parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit (CA. nr. 712/2013 të 21 tetorit 2013) janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 prill 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI72/14 caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI72/14 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 16 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe ua dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe MKK-së.
9. Më 18 shtator 2014, Kryetari ndryshoi Vendimin (KSH. KI72/14 të 6 majit 2014) dhe caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
10. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesja e kërkesës ishte e punësuar në MKK si Zyrtare për barazi gjinore, në bazë të kontratës për periudhë të caktuar kohore prej 1 qershorit 2007 deri më 30 maj 2009.
12. Më 22 janar 2008, Komisioni disiplinor i MKK-së vendosi të caktojë masën disiplinore: ndërprerjen e kontratës së punës së parashtrueses së kërkesës me MKK-në (në tekstin e mëtejme: Vendimi i Komisionit disiplinor).
13. Më 24 janar 2008, MKK-ja në bazë të Vendimit të saj Nr. 108 ndërpreu marrëdhënien e punës (në tekstin e mëtejme: Vendimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës) me parashtruesen e kërkesës.

Procedura administrative

14. Më 31 mars 2008, pas ankesës së parashtrueses së kërkesës kundër Vendimit të Komisionit disiplinor dhe Vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia i MKK-së, bazuar në Vendimin e tij Nr. 484/1 (në tekstin e mëtejme: Vendimi i Komisionit për Ankesa) e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës.
15. Më 11 prill 2008, parashtruesja e kërkesës ushtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHCK) kundër Vendimit të Komisionit disiplinor, Vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe Vendimit të Komisionit për Ankesa.
16. Më 25 maj 2009, KPMK-ja me Vendimin A02 (114) 2008 (në tekstin e mëtejme: Vendimi i KPMK-së) vendosi si në vijim:

“I. APROVOHET si e bazuar ankesa nr. 02 i 14/08 e datës 11.04.2008 e ankueses znj. Besa Qirezi.

II. ANULOHEN: Vendimi i Organit të Punësimit nr. 484/1 të datës 31.03.2008. Aktvendimi nr. 108 i datës 24.01.2008 dhe Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 22.01.2008.

III. OBLIGOHET - Organi i punësimit që në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij Vendimi, ankuesit t'ia mundësojë kthimin në punë dhe realizimin e të gjitha të drejtave nga mardhënia e punës dhe t'i përtrijë kontratën e punës në pajtim me procedurën sipas Udhëzimit Administrativ nr. MSHP/DASHC 2003/02.

IV. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Sekretari i Përhershëm i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

V. Pas ndërmarrjes së masave sipas këtij vendimi, të njoftohet Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës.

VI. Në rast mosveprimi sipas këtij vendimi Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, do të njoftojë Kuvendin e Kosovës, i cili ia përcjellë raportin Kryeministrit të Kosovës në përputhje me nenin 2 parag. 11.4 të Rregullores Nr. 2001136 mbi Shërbimin Civil të Kosovës e ndryshuar me Rregulloren nr. 2008/12”.

17. Më 6 korrik 2009, parashtruesja e kërkesës e njoftoi KPMK-në se MKK-ja nuk e kishte përmbaruar Vendimin e KPMK-së.
18. Në një datë të pacaktuar, MKK-ja kishte paraqitur padi në Gjykatën Supreme kundër Vendimit të KPMK-së.
19. Më 24 mars 2010, Gjykata Supreme, me Aktvendimin A. nr. 472/2009 shpallet jokompetente për të vendosur lidhur ma padinë e parashtruar nga MKK-ja. Gjykata Supreme ia përcolli lëndën Gjykatës Komunale në Prishtinë si gjykatë kompetente për këtë çështje.
20. Gjykata Supreme në vendimin e lartcekur konstatoi se:

“Me nenin 9 par. 1 pika 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, parashikohet se konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet për çështje për të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ.

Gjykata Supreme vlerëson se në rastin konkret bëhet fjalë për kontest nga marrëdhënia e punës, për vendosjen e të cilit, në përputhje me nenin 26 par.1 pika 7 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta (Gaz . Zyrtare e Kosovës nr. 21/78), kompetente është gjykata komunale.

Nga sa u tha më lart, Gjykata Supreme, në përputhje me nenin 60 të LKA, lidhur me nenin 15 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi”.

21. Më 17 qershor 2010, parashtruesja e kërkesës e informoi Kryeministrin për mospërmbarimin e Vendimit të KPMK-së dhe gjithashtu kërkoi nga ai që të ndërmerr masat e nevojshme për përmbarimin e Vendimit të KPMK-së. Kjo kërkesë e parashtrueses i ishte përcjellë Kuvendit të Kosovës, më 7 korrik 2010.
22. Më 7 shtator 2010, kryetari i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione në Konkluzionin e tij adresuar MKK-së, kërkoi nga MKK-ja që të ndërmerr masa të nevojshme për përmbarimin e Vendimit të KPMK-së.

Procedura kontestimore

23. Në përpjekje për të përtërirë marrëdhënien e saj të punës duket se parashtruesja ishte përfshirë në procedurë kontestimore si paditëse. Për më tepër, si rezultat i Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, një procedurë kontestimore gjithashtu ishte iniciuar edhe me MKK-në si paditëse. Këto dy procedura kontestimore megjithatë nuk janë relevante për pretendimet e ngritura në këtë kërkesë.

Vendimi i MKK-së për kthimin e parashtrueses së kërkesës në vendin e saj të punës

24. Më 21 nëntor 2012, Sekretari i Përgjithshëm i MKK-së, me qëllim të përmbarimit të Vendimit të KPMK-së, nxori Vendimin për kthim të parashtrueses së kërkesës në një vend të punës në MKK, por në një pozitë tjetër,

atë të Zyrtares për pranim të kërkesave në Zyrën për Komunikim Publik me MKK-në.

25. Në vendimin e njëjtë, MKK-ja vendosi më tej që kompensimi i parashtrueses së kërkesës do të bëhet si në vijim: ” [...] *kompensimi i të ardhurave personale në pagë mujore i bëhet që nga dt. 22.01.2008 kur dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga ana e Komisionit Disiplinor të MKK-së deri më dt. 31.05.2009, kur dhe i ka skaduar kontrata e punës Nr. 226/2007. [...]*”.
26. Më 3 dhjetor 2012, parashtruesja e kërkesës ishte kthyer në vendin e saj të punës.
27. Më 17 dhjetor 2012, Sekretari i Përgjithshëm i MKK-së nxori Vendimin për transferimin e parashtrueses së kërkesës në Divizionin për të Drejta të Njeriut në MKK, në vendin e saj të mëparshëm të punës Zyrtare për Barazi Gjimore.

Procedura përmbarimore

28. Si rezultat i Vendimit të MKK-së për kompensimin e pagave vetëm për periudhën nga dita kur parashtrueses së kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës deri në ditën kur i kishte skaduar kontrata (22 janar 2008 e deri më 31 maj 2009), më 26 dhjetor 2012, parashtruesja e kërkesës parashtrroi propozim për përmbarimin e pagave të papaguara për periudhën prej 1 qershorit 2009, dita kur kishte skaduar kontrata e mëparshme e punës deri më 3 dhjetor 2012, dita e kthimit në vendin e saj të punës në MKK.
29. Më 11 shkurt 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin E. nr. 2668/2012 vendosi që ta përmbarojë propozimin e parashtrueses së kërkesës për pagat e papaguara për periudhën ndërmjet 1 qershorit 2009 dhe 3 dhjetorit 2012.
30. Më 6 mars 2013, sipas kundërshtimit të MKK-së ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, (E. nr. 2668/2012, të 11 shkurtit 2013), Gjykata Themelore në Prishtinë refuzoi në tërësi kundërshtimin e parashtruar nga MKK-ja.
31. Rrjedhimisht, MKK-ja ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë (E. nr. 2668/2012, të 6 marsit 2013).
32. Më 21 tetor 2013, Gjykata e Apelit me Aktvendimin, CA. nr. 712/2013 aprovoi ankesën e MKK-së, në cilësi të debitorit dhe refuzoi propozimin e parashtrueses së kërkesës për përmbarimin e Aktvendimit të KPMK-së.
33. Gjykata e Apelit, në Aktvendimin e lartcekur konstatoi:

“Nga shkresat në dosje rezulton: Se procedura e përmbarimit për kthimin në punë të kreditorit sipas vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës A02(114) 2008 i datës 25.5.2009, ka përfunduar me datën 3.12.2012 sipas vendimit të Ministrisë për komunitete dhe kthim nr. 2517 të datës 21.11.2012, ndërsa kreditori e ka paraqitur propozimin për shpërblim pas përfundimit të procedurës së përmbarimit, pra me datë 26.12.2012.”

Gjykata e shkallës së parë ka caktuar përmbarimin me aktvendimin e saj E. nr. 2668/2012 të datës 11.02.2013. Kundër këtij aktvendimi debitori kishte paraqitur prapësim, ndërsa gjykata e shkallës së parë kishte vendosur si në dispozitivin e aktvendimit ankimor, duke vlerësuar se nuk ka pengesa ligjore për zbatimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbarimit, por paraprakisht nuk kishte shqyrtuar se propozimi për përmbarim a ishte paraqitur brenda afatit ligjor.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë të dhënë në aktvendimin ankimor, kolegji e vlerëson të pa drejtë dhe të pabazuar në ligj, sepse me nenin 294 par. 2 të Ligjit për procedurën Përmbarimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 33/2008) më tej LPP është përcaktuar: "Propozimi për shpërblim mund t'i bashkëngjitet propozimit për përmbarim, ose mund të paraqitet më vonë deri në përfundimin e procedurës së përmbarimit". Në rastin konkret procedura e përmbarimit për kthimin e kreditorit në punë ka përfunduar me dt. 03.12.2012, ndërsa propozimin kreditori e ka paraqitur me dt. 26.02.2012 [26.12.2012], e që do të thotë pas skadimit të afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën e lart cituar të LPP".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Siç u cek më lart, parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit (CA. nr. 712/2013 të 21 tetorit 2013) i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së si dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.
35. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës argumenton që *"Mirëpo Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e përmbaroi në tërësi vendimin e KPMK-së, sepse më kompensojë pagat vetëm për periudhën sa kam pas kontratë, ndërsa për periudhën sa kam qenë e papunë, u arsyetua se nuk ka "mjete financiare". Si është e mundur që për mua MKK nuk paska mjete monetare për kompensimin e rrogave të humbura, kurse për kolegun tim, i cili është larguar dhe është kthyer në të njëjtën kohë në punë me mua, i'u bë kompensimi? Mua padrejtësisht më është mohuar e drejta e përfitimit të pagave të humbura, ndërkohë që kolegut tim i'a kompensuan pagat e humbura? Kjo provon më së miri trajtimin e pabarabartë të individëve".*
36. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës pretendon që:

"[...] sipas praktikës së GJEDNJ-së çështjet e mospërmbarimit të vendimeve të formës së prerë res judicata paraqesin shkelje të vazhdueshme sepse një e drejtë e fituar nuk duhet të ngelet vetëm në letër, ose pjesërisht e zbatuar por duhet të realizohet edhe në praktikë, shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI129/11, pjesë të cituara nga gjykata e Strasburgut.

Nuk kam faj unë nëse MKK-ja nuk ka të holla për të më kompensuar. KPMK ka marr një vendim me të cilin mua duhet të më kompensohen pagat e

humbura nga dita e largimit tim nga puna deri në kthimin tim në punë. Shteti duhet të gjejë mekanizma për të siguruar zbatimin e vendimeve të autoriteteve publike, pse duhet të jem unë viktimë e mungesës së këtyre mekanizmave?”.

37. Për më tepër, siç u cek më lart, parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës pretendon që: *“Si rrjedhojë e mospërmbarimit në tërësi të vendimit të KPMK-së mua më janë mohuar të drejtat e fituara, sepse pritjet e mia kanë qenë legjitime, me këtë rast më është cënuar e drejta ime”.*
38. Parashtruesja e kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata si në vijim: *“[...] duke u referuar sipas Aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës: KI72/12, KI29/11, KI04/12 dhe fakteve që u përmendën, kërkoj nga Gjykata Kushtetuese që të vendos në bazë të meritave të kërkesës sime, dhe ta shfuqizojë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit CA. nr. 712/2013, të dt. 21.10.2013”.*

Dispozitat relevante ligjore në lidhje me procedurat për përmbarimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore

Ligji për Procedurën Përmbarimore (Ligji Nr. 03/L-008)

Neni 1 [Përmbajtja e ligjit]

“1.1 Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutiv (procedura e përmbarimit), po që se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.

1.2 Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të dhënë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër”.

Neni 24, paragrafi 1 [Titulli ekzekutiv]

“Tituj ekzekutiv janë:

- a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive ; 10*
- b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po që se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po që se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër;*
- c) dokumenti noterial ekzekutiv;*
- d) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv”.*

Neni 26, paragrafi 3 [Përmbarueshmëria e vendimit]

“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimorë, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”.

Neni 294, paragrafi 1 [Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë]

“Propozuesi i përmbarimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se, debitori ka për detyrë që atij t’ia paguajë në emër të pagës shumë mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbarimin për realizimin e shumëve mujore të caktuara”.

Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nr. 03/L-192

Neni 13 [Vendimi i Këshillit]

“Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarë të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit”.

Neni 14 [E drejta e ankesës]

“Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit”.

Neni 15 [Procedura në rast mos zbatimi të vendimit të këshillit]

“Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”.

Pranueshmëria e kërkesës

39. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

41. Gjykata gjithashtu i referohet neneve 48 dhe 49 të Ligjit, të cilët parashohin se:

48. Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

49. Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.

42. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar, ose

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar, ose

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi; ose

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

43. Sa i përket shterjes së mjeteve juridike, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në institucionet e punësimit dhe me ankesën e saj në KPMK, i cili vendim është final në procedurën administrative. Ajo gjithashtu kishte shteruar mjetin e fundit juridik në procedurën përmbartimore, që në rastin konkret është Aktvendimi, CA. nr. 712/2013 të Gjykatës së Apelit, të 21 tetorit 2013, ndaj të cilit nuk lejohet e drejta e ankesës. Si rezultat, parashtruesja e kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas legjislacionit në fuqi.
44. Gjykata më tej vëren se më 16 dhjetor 2013, parashtrueses së kërkesës i ishte dorëzuar vendimi i kontestuar dhe më 14 prill 2014, ajo e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë.
45. Gjykata gjithashtu vëren që parashtruesja e kërkesës kishte saktësuar cilat të drejta kushtetuese pretendohen t'i jenë shkelur dhe ajo e konteston vendimin konkret, gjegjësisht, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit (CA. nr. 712/2013, të 21 tetorit 2013).
46. Gjykata më tej vëren se parashtruesja e kërkesës mundet në mënyrë legjitime të pretendojë të jetë viktimë e anulimit të Aktvendimit të Gjykatës Komonale në Prishtinë (E. nr. 2668/2012, i 6 marsit 2013) nga Gjykata e Apelit, i cili ishte nxjerrë në dobi të saj.
47. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, se e ka dorëzuar kërkesën në afatin ligjor dhe se ajo e kishte specifikuar saktësisht shkeljen e pretenduar të të drejtave dhe lirive dhe i është referuar vendimit të cilin ajo e konteston.
48. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa i plotëson të gjitha kriteret për pranueshmëri.

Meritat e rastit

49. Parashtruesja e kërkesës kryesisht pretendon shkeljen e të drejtës së saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe të drejtën për mbrojtje të pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1, të Protokollit Nr. 1, të KEDNJ-së.
50. Gjykata shqyrton meritat e çdo pretendimi të parashtrueses së kërkesës.
51. Parashtruesja e kërkesës ankohet se është shkelur e drejta e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.
52. Neni 31.1 i Kushtetutës përcakton:
- Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
53. Përveç kësaj, neni 6.1 i KEDNJ-së përcakton:
- Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.*
54. Gjykata i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili përcakton:
- Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*
55. Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) mjaft shpesh e ka theksuar vendin e shquar të së drejtës për gjykim të drejtë në një shoqëri demokratike (shih, *Perez kundër Francës*, nr. 47281/99, GJEDNJ, Aktgjykimi i 12 shkurtit 2004).
56. Siç është përmendur në fakte, dy procedura kontestimore ishin iniciuar nga MKK-ja dhe nga parashtruesja e kërkesës në anën tjetër. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se procedurat kontestimore nuk bien nën fushëveprimin e kërkesës dhe prandaj, do të shqyrtojë vetëm procedurën lidhur me objektin e çështjes së kërkesës.
57. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, CA. nr. 712/2013, të 21 tetorit 2013, me të cilin është anuluar Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë (E. nr. 2668/2012, i 6 marsit 2013) për përmbarimin e propozimit të parashtrueses së kërkesës për kompensimin e pagave të papaguara.

58. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, më 25 maj 2009, KPMK-ja (Vendimi nr. A02 (114) 2008) aprovoi ankesën e parashtrueses së kërkesës, duke kërkuar nga MKK-ja që brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita kur u është dorëzuar vendimi, ta kthejë parashtruesen e kërkesës në vendin e saj të punës me të gjitha të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe përtëritjen e kontratës së punës në pajtim me procedurat e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. MPS/DCSA 2003/02. Në Vendimin e KPMK-së theksohet se:

Vendimi i Këshillit paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet prej zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.

59. Gjykata vëren se pas Vendimit të KPMK-së, MKK-ja nuk e ka kthyer parashtruesen e kërkesës në vendin e saj të mëparshëm të punës brenda afatit të paraparë me Vendimin e KPMK-së.
60. Vetëm më 21 nëntor 2012, më shumë se 3 (tri) vjet pas nxjerrjes së Vendimit të KPMK-së, MKK-ja me Vendimin e Sekretarit të saj të Përgjithshëm vendosi të kthejë parashtruesen e kërkesës në vendin e punës në MKK dhe si rezultat, më 3 dhjetor 2012, parashtruesja e kërkesës ishte kthyer në vendin e saj të punës në MKK.
61. Në këtë drejtim, duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore, Gjykata rikujton që KPMK-ja është institucion i pavarur i konstituuar me ligj, në pajtim me nenin 101.2 të Kushtetutës. Prandaj, të gjitha obligimet që dalin nga vendimet e këtij institucioni, lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e tij, prodhojnë efekte juridike për institucionet tjera përkatëse, ku statusi i të punësuarve është i rregulluar me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Vendimi i KPMK-së paraqet vendim përfundimtar dhe detyrues, dhe se ankesa e ushtruar kundër Vendimit të KPMK-së nuk e ndalon përmbarimin e vendimeve të KPMK-së (Shih Rastin KI129/11, parashtrues i kërkesës *Viktor Marku*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykimi i 17 korrikut 2012).
62. Megjithatë, sa i përket kompensimit të pagave të papaguara, MKK-ja në Vendimin e 11 nëntorit 2012 vendosi që ” [...] *kompensimi i të ardhurave personale në pagë mujore i bëhet që nga dt. 22.01.2008 kur dhe i është ndërpre marrëdhënia e punës nga ana e Komisionit Disiplinor të MKK-së, deri më dt. 31.05.2009, kur dhe i ka skaduar kontrata e punës Nr. 226/2007.[...]*”. Kjo do të thotë që MKK-ja kishte vendosur mos ta kompensojë parashtruesen e kërkesës për periudhën prej 1 qershorit 2009, dita kur kishte skaduar kontrata e saj e mëparshme e punës, deri më 3 dhjetor 2012, dita e kthimit në vendin e saj të punës në MKK. Si i tillë, Vendimi i MKK-së nuk është në pajtim me Vendimin e KPMK-së.
63. Gjykata më tej vëren se si pasojë e mospërmbarimit të Vendimit të KPMK-së në tërësi, parashtruesja e kërkesës ka vendosur të iniciojë procedurë për përmbarim dhe të propozojë kompensimin e pagave të papaguara për periudhën e lartpërmendur prej 1 qershorit 2009 deri më 3 dhjetor 2012. Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin e saj (E. nr. 2668/2012, i 11 shkurtit 2013) dhe në bazë të vendimeve të KPMK-së miratoi propozimin e

parashtrueses së kërkesës për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën e lartpërmendur.

64. Megjithatë, si rezultat i ankesës së parashtruar nga MKK-ja kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit miratoi ankesën e paraqitur nga MKK-ja dhe hodhi poshtë propozimin e parashtrueses së kërkesës për ekzekutimin e Vendimit të KPMK-së, respektivisht propozimit për kompensimin e pagave të papaguara dhe zëvendësoi Vendimin e KPMK-së me vendimin e vet.
65. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të sqarojë se nuk është detyrë e saj që të shqyrtojë nëse Gjykata e Apelit me Aktvendimin e saj ka interpretuar drejt ligjin e aplikueshëm, por të shqyrtojë dhe të merr parasysh nëse ajo me vendimin e saj të lartpërmendur kishte cenuar të drejtat dhe liritë individuale të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
66. Si rezultat i anulimit të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me Aktvendim të Gjykatës së Apelit (CA. nr. 712/2012 të 21 tetorit 2013), parashtruesja e kërkesës pretendon se mospërmbarimi i Aktvendimit të KPMK-së në tërësi, përkatësisht moskompensimi i pagave të papaguara për periudhën e sipërpërmendur përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
67. Në këtë drejtim, Gjykata duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore (Shih, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese, Rasti K104/12, parashtrues i kërkesës *Esat Kelmendi*, Aktgjykimi i 20 korrikut 2012), thekson se një vendim i lëshuar nga një organ administrativ i themeluar me ligj, prodhon efekte juridike për palët dhe, për këtë arsye, një vendim i tillë është një vendim përfundimtar administrativ dhe i përmbarueshëm.
68. Bazuar në sa u tha më lart, Gjykata konfirmon se vendimi i formës së prerë, përkatësisht vendimi që konsiderohet të jetë objekt i procedurës përmbarimore është Vendimi i KPMK-së. Vendimi i KPMK-së detyron MKK-në që ta kthejë parashtruesen e kërkesës në vendin e saj të mëparshëm të punës me të gjitha të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe të përtërijë kontratën e punës, e cila kishte skaduar më 31 maj 2009. Prandaj, Gjykata konkludon se Vendimi i KPMK-së është i formës së prerë dhe i përmbarueshëm. Kjo nënkupton se parashtruesja e kërkesës ka të drejtë për t'u rikthyer në vendin e saj të mëparshëm të punës në MKK dhe, për t'iu paguar të gjitha pagat e papaguara nga momenti i shkarkimit nga puna deri në kthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës.
69. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se përmbarimi i një vendimi të formës së prerë dhe të detyrueshëm duhet shikuar si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Parimi i lartpërmendur është i një rëndësie të madhe në kuadër të procedurës administrative në lidhje me një kontest, rezultati i të cilit është i një rëndësie të veçantë për të drejtat civile të palëve në kontest (Shih, *mutatis mutandis*, rasti *Hornsby kundër Greqisë*, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 marsit 1997, para. 40-41, shih gjithashtu Rastin K112/12, parashtrues i kërkesës *Adem Meta*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykim i 5 korrikut 2013).

70. Nga kjo rrjedh që Gjykata e Apelit, kur kishte anuluar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë për përmbarrimin e një vendimi përfundimtar dhe të përmbarrueshëm administrativ të KPMK-së, kishte shkelur të drejtën e parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
71. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së.
72. Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] parasheh që:
- Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*
73. Përveç kësaj, neni 13 i KEDNJ-së parasheh që:
- Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.*
74. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion në lidhje me përmbarrimin e Vendimit të KPMK-së. Megjithatë, pavarësisht nga përpjekjet e saj, ai vendim nuk ishte përmbarruar as nga MKK-ja dhe as nga Gjykata e Apelit.
75. Gjykata rithekson se mosekzistimi i mjeteve juridike apo i mekanizmave të tjerë efektivë për përmbarrimin e Vendimit të KPMK-së cenon të drejtën e garantuar me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, dhe të nenit 13 të KEDNJ-së.
76. Për më tepër, “organet kompetente kanë për obligim që ta themelojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI50/12, Parashtrues i kërkesës Agush Llulluni, Aktgjykim i 16 korrikut 2012, para. 41, shih gjithashtu Pecevi kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, GJEDNJ, Aktgjykim i 6 nëntorit 2008).
77. Prandaj, Gjykata konkludon se pamundësia për të ndërmarrë veprime të mëtejshme juridike përkitazi me mospërmbarrimin e vendimit të KPMK-së, gjithashtu përbën shkelje të nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së.
78. Parashtruesja e kërkesës po ashtu pretendon shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
79. Parashtruesja e kërkesës pretendon që: “Si rrjedhojë e mospërmbarrimit në tërësi të vendimit të KPMK-së mua më janë mohuar të drejtat e fituara, sepse pritjet e mia kanë qenë legjitime, me këtë rast me është cënuar e drejta ime”.

80. Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] e Kushtetutës përcakton:

1. *E drejta e pronës është e garantuar.*
2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

81. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së parasheh:

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

82. Siç u theksua më lart, Gjykata rikujton se Vendimi i KPMK-së ishte përfundimtar dhe i përmbarueshëm.

83. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konsideron se parashtruesja e kërkesës ka një "pritje legjitime" të merr kompensim për pagat e papaguara për periudhën e lartcekur, në pajtim me Vendimin e KPMK-së, i cili mori formën e prerë dhe është i përmbarueshëm. (Shih, *mutatis mutandis*, rasti *Pressos Compania Naviera SA e tjerët kundër Belgjikës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 20 nëntorit 1995, paragrafi 31).

84. Pritja e tillë legjitime gjithashtu garantohet me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës (Shih, *mutatis mutandis*, *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, nr. 39794/98, GJEDNJ, Vendim i 10 korrikut 2002, para. 73).

85. Nga arsyet e mësipërme, dhe duke u bazuar në përfundimin e mësipërm se është shkelur e drejta e parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata më tej konstaton se mospërmbarimi i Vendimit të KPMK-së në lidhje me pagat e papaguara përbën gjithashtu shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

86. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

87. Përfundimisht, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme që të merret më tej me pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, sidomos pasi ajo ka gjetur shkelje të neneve relevante 31, 54 dhe 46 të Kushtetutës dhe nenit 6 dhe 13 të KEDNJ-së si dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Përfundim

88. Në përfundim, Gjykata konstaton se mospërmbarimi i Vendimit të KPMK-së në tërësi nga ana e autoriteteve kompetente administrative dhe nga gjykatat e rregullta për pjesën e kompensimit të pagave të papaguara, përbën shkelje të neneve 31 dhe 54 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së. Si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtruesja e kërkesës ishte privuar nga e drejta e saj që të merr kompensim për pagat e papaguara. Në këtë mënyrë, është shkelur e drejta për mbrojtje të pronës, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Prandaj, vendimi i KPMK-së për pjesën e kompensimit të pagave të papaguara nga momenti i shkarkimit të saj nga puna deri në momentin e kthimit të saj në vendin e punës në MKK, gjegjësisht për periudhën prej 1 qershorit 2009 deri më 3 dhjetor 2012, mbetet për t'u përmbuar.
89. Gjykata më tej thekson se ky përfundim ka të bëjë vetëm me shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Në të vërtetë, përfundimi nuk ka të bëjë me faktin nëse vendimi i gjykatave të rregullta ose Vendimi i KPMK-së interpreton drejt ligjin e aplikueshëm, për shkak se Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me atë se çfarë është interpretim i duhur i ligjit.
90. Si përmbledhje, në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, Vendimi i Gjykatës së Apelit (CA. nr. 712/2013, i 21 tetorit 2013) është i pavlefshëm dhe, lënda i kthehet Gjykatës së Apelit për rishqyrtim.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit, dhe me rregullat 56 (a) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, njëzëri, në seancën e saj të mbajtur më 9 dhjetor 2014

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së;
- III. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së;
- IV. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1, të Protokollit Nr. 1, të KEDNJ-së;
- V. TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, CA. nr. 712/2013 të 21 tetorit 2013, DHE TË KTHEJË rastin në Gjykatën e Apelit për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht të merr parasysh se Vendimi i KPMK-së duhet të përmbahet në tërësi;
- VI. T'UA PËRKUJTOJË autoriteteve kompetente obligimet e tyre sipas nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës dhe rregullit 63 [Zbatimi i vendimeve] i Rregullores së punës të Gjykatës;
- VII. TA URDHËROJË Gjykatën e Apelit, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, t'i dorëzojë Gjykatës Kushtetuese informata për masat e ndërmarra për përmbahimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese;
- VIII. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve;
- IX. TA PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- X. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani